



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 181, DATË 11.09.2017



**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“MBI PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE NGA KËSHILLI I ANKESAVE DHE TË
DREJTËN E PËRGJIGJES”**

Në mbështetje të neneve 19, pika 16, 51, 52 dhe 53 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli Ankesave dhe të drejtën e përgjigjes”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:	Gentian	SALA	
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ	
Anëtarë:	Agron	GJEKMARKAJ	
	Gledis	GJIPALI	
	Piro	MISHA	
	Suela	MUSTA	
	Zylyftar	BREGU	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

RREGULLORE

**MBI PROCEDURAT PËR TRAJTIMIN E ANKESAVE
DHE PËR USHTRIMIN E SË DREJTËS SË PËRGJIGJES**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti dhe qëllimi i rregullores**

Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat për trajtimin e ankesave të paraqitura mbi programet e transmetuara prej ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv dhe për ushtrimin e së drejtës së përgjigjes.

**Neni 2
Baza ligjore**

Dispozitat e kësaj rregulloreje hartohen në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si edhe të çdo akti tjeter nënligor që nuk bie ndesh me parimet e kësaj rregulloreje.

**Neni 3
Përkufizime**

Termat e përdorur në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si më poshtë:

1. "Këshilli i Ankesave", organ konsultativ i caktuar nga AMA, i përbërë nga kryetari dhe 2 anëtarë, specialistë të fushës së medias, me objekt të punës kontrollin e respektimit të kërkesave të ligjit dhe rregulloreve të transmetimit;
2. "Ankues", çdo person fizik, person juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjisacionit në fuqi;
3. "Kërkues", çdo person fizik, person juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjisacionit në fuqi;

4. "Ofrues i shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA)", është personi fizik ose juridik, që ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv dhe që vendos mënyrën e organizimit të saj.

KREU II

PROCEDURA PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE NGA KËSHILLI I ANKESAVE

Neni 4

Ankesa dhe forma e depozitimit të saj

1. Çdo individ, person fizik ose juridik ka të drejtë t'i drejtohet nëpërmjet një ankesë, Këshillit të Ankesave në AMA, lidhur me transmetimin e lajmeve dhe programeve.
2. Ankesa paraqitet pranë Këshillit të Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëra-tjetër, nga data e transmetimit më të vonë.
3. Ankesa paraqitet me shkrim dhe duhet të përmbajë të dhëna të rëndësishme, përfaktë dhe rrethana mbi cenimin nga OSHMA-të, të detyrimeve të parashikuara në nenin 33 të ligjit nr. 97/2013, dhe rregulloreve të transmetimit të përcaktuara sipas nenit 47 të tij. Kërkesa me shkrim mund të dërgohet edhe me mjete elektronike ose faks, në adresën zyrtare të AMA-s.
4. Ankesa duhet të paraqitet në përputhje me formularin i cili duhet të përmbajë minimalisht këto elemente:
 - a. Të dhëna mbi ankuesin, të identifikuar në mënyrë të qartë; dhe
 - b. Të dhëna mbi OSHMA, objekt i ankesës; dhe
 - c. Përshkrimin e shkeljeve të supozuara apo rrethanave konkrete të pretenduara, datën dhe orën e transmetimit të programit;
5. Formulari i ankesës mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e internetit të AMA-s ose mund të tërhiqet pranë zyrave të AMA-s.
6. Në rast se ankesa nuk përbush kriteret formale të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij nenit, Këshilli i Ankesave, brenda 2 ditëve nga mbërritja e ankesës, kërkon plotësimin e të metave të ankesës.

Neni 5

Procedura e shqyrtimit të ankesës

1. Këshilli i Ankesave merr në shqyrtim ankesën e depozituar, brenda 10 ditëve nga depozitimi i saj.
2. Këshilli i Ankesave, njofton OSHMA-në për ankesën e depozituar dhe kërkon nga OSHMA, që brenda 7 ditësh nga marrja e njoftimit, të paraqesë pretendimet dhe provat e saj.
3. Këshilli i Ankesave ka të drejtë të organizojë seanca dëgjimore me palët.
4. Kur e njëjtë çështje ka qenë objekt i shumë ankesave të paraqitura, Këshilli i Ankesave, i paraqet AMA-s, propozim mbi mënyrën e zgjidhjes së saj.
5. Këshilli i Ankesave, në rastin kur paraqitet ankesë mbi transmetimin e lajmeve dhe programeve nga ofrues të shërbimit mediatik audio dhe/oze audiovizive që janë jashtë

juridiksonit territorial të AMA-s, njofton kërkuesin menjëherë, dhe në çdo rast jo më vonë se dy ditë nga marrja e saj mbi mungesën e kompetencës për shqyrtimin e ankesës.

Neni 6 **Konkluzionet e Këshillit të Ankesave**

1. Këshilli i Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të OSHMA-së, vendos lidhur me zgjidhjen e ankesës jo më vonë se 30 ditë nga data e depozitimit të saj.
2. Vendimi i Këshillit të Ankesave duhet të jetë i argumentuar. Ai duhet të përmbajë:
 - a) objektin e verifikimit;
 - b) pretendimet e ngritura nga ana e palës ankuese;
 - c) pretendimet apo arsyetimet e mundshme të OSHMA;
 - d) referencë të dokumenteve, faktet dhe rrëthanat që përbëjnë shkelje në referim të ligjit dhe standardeve profesionale;
 - e) përbledhjen e të dhënave kryesore të rastit të verifikuar;
 - f) përfundimet nëse ekzistojë në rastin konkret shkelje të ligjit, si dhe vlerësimin nëse ato përbëjnë ose jo shkaqe të arsyeshme për marrjen e sanksioneve ndaj OSHMA;
 - g) propozimin për AMA lidhur me marrjen e masave përkatëse.
3. Në çdo rast, Këshilli i Ankesave njofton me shkrim personin që ka paraqitur ankesën dhe OSHMA-në përkatëse mbi konkluzionet dhe masat e propozuara.
4. Pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të OSHMA-së, Këshilli i Ankesave, nëse çmon se ka shkelje, i propozon AMA-s, masat përkatëse.

Neni 7 **Mbajtja dhe administrimi i dokumentacionit**

1. Këshilli i Ankesave për çdo ankesë harton dhe mban një dosje, e cila përmban detyrimisht të gjithë dokumentacionin e administruar gjatë procesit të shqyrtimit që nga fillimi i tij deri në përfundimin e procesit.
2. Në çdo mbledhje të Këshillit të Ankesave të zhvilluar për një ankesë të caktuar mbahet procesverbal, ku pasqyrohen data, vendi, rendi i ditës, anëtarët pjesëmarrës në mbledhje, drejtuesi i saj, si dhe çështjet që janë diskutuar. Në fund të mbledhjes, procesverbal i nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm.

Neni 8 **Udhëzimet mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga OSHMA-të**

1. Këshilli i Ankesave miraton udhëzimet për OSHMA-të, mbi procedurat e trajtimit të ankesave.
2. Udhëzimet e miratuara nga Këshilli i Ankesave publikohen në faqen e internetit të AMA-s.

Neni 9

Detyrimet e OSHMA-së për trajtimin e ankesave

1. Çdo OSHMA duhet të përgatisë dhe të zbatojë procedura të caktuara për trajtimin e ankesave, në përputhje me udhëzimet e Këshillit të Ankesave. Këto procedura duhet të parashikojnë:
 - a) mënyrën dhe vendin e paraqitjes së ankesës;
 - b) afatin, brenda të cilil transmetuesit duhet të kthejnë përgjigje;
 - c) mënyrën e zgjidhjes së ankesës përkatëse.
2. OSHMA-ja paraqet informacionin e kërkuar sipas pikës 1 të këtij neni, në Këshillin e Ankesave, çdo 6 muaj. Ky informacion mund të publikohet në faqen e internetit të AMA-s.
3. OSHMA-ja mban ankesat e paraqitura për lajmet dhe programet e transmetuara si dhe përgjigjet e tyre për një periudhë prej dy vjetësh nga data e regjistrimit të ankesës.
4. OSHMA-ja është e detyruar të lejojë inspektimin nga ana e Këshillit të Ankesave të regjistimeve të ankesave të bëra sipas pikës 1 të këtij neni.
5. OSHMA-ja transmeton konkluzionin e Këshillit të Ankesave, kur ky konkluzion është në favor të personit që ka kryer ankesën, brenda 2 ditëve nga marrja e njoftimit, në edicionin e ardhshëm të të njëjtit program ndaj të cilil është ushtruar ankesa përkatëse.

Neni 10

Sanksioni në përfundim të procedurës së shqyrtimit të ankesës

AMA, pas shqyrtimit të propozimit të Këshillit të Ankesave në rast se konstaton shkelje të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, dënon OSHMA-në, me gjobë, në përputhje me parashikimet e nenit 133 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

KREU III E DREJTA E PËRGJIGJES

Neni 11

Kërkesa

1. Çdo person fizik apo juridik, dinjiteti dhe reputacioni i të cilil janë prekur nga publikimi i faktave dhe informacioneve jo të sakta në një transmetim, ka të drejtën e përgjigjes.
2. Personi që kërkon të drejtën e përgjigjes, duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim, drejtar OSHMA-së, për të cilin pretendohet se ka transmetuar fakte dhe informacione jo të sakta.
3. Kërkesa duhet të përbajë arsyet dhe faktet me të cilat provon pretendimin e tij.
4. Kërkesa për të drejtën e përgjigjes duhet të paraqitet tek OSHMA-ja, brenda 10 ditëve nga dita e transmetimit, të cilil i adresohet kjo kë rkesë.

Neni 12 Shqyrtimi i kërkesës

1. OSHMA-ja, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës, vendos për ushtrimin ose refuzimin e së drejtës së përgjigjes.
2. Nëse është e nevojshme, OSHMA-ja ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë nga kerkuesi lidhur me pretendimet e ngritura për cënimin e dinjitetit dhe reputacionit.
3. OSHMA-ja njofton me shkrim kerkuesin lidhur me vendimin e marrë si më sipër.
4. Nëse brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të ketij neni, kerkuesi nuk merr një përgjigje, prezumohet se OSHMA-ja ka refuzuar kërkesën.

Neni 13

Ushtrimi i të drejtës së përgjigjes

1. Kur OSHMA-ja vendos për ushtrimin e të drejtës së përgjigjes, ajo duhet të transmetojë përgjigjen brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës.
2. E drejta e përgjigjes duhet të paraqesë se në çfarë mase informacioni i paraqitur gjatë transmetimit është jo korrekt dhe mashtrues dhe të kufizohet në pohimin e fakteve të nevojshme për korrigimin e fakteve apo informacioneve të pavërteta.
3. Për realizimin e kërkesave të ushtrimit të së drejtës së përgjigjes, OSHMA-ja nuk mund të aplikojë asnjë lloj tarife.

Neni 14

Ankesa për refuzimin e të drejtës së përgjigjes nga OSHMA-ja

1. Në rastin e refuzimit të të drejtës së përgjigjes nga OSHMA-ja, personi, i cili pretendon se i është prekur dinjiteti dhe reputacioni, ka të drejtë t'i drejtohet me ankesë Këshillit të Ankesave në AMA.
2. Ankesa paraqitet pranë Këshillit të Ankesave brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të refuzimit.

Neni 15

Procedura për shqyrtimin e ankesës për refuzimin e të drejtës së përgjigjes

1. Këshilli i Ankesave shqyrton çështjen lidhur me refuzimin e së drejtës së përgjigjes nga OSHMA-ja brenda 15 ditëve nga paraqitja e ankesës.
2. Në fillim të procedurës së shqyrtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave i kërkon OSHMA-së, të cilit i adresohet ankesa, dhënien e shpjegimeve në lidhje me këtë ankesë.
3. OSHMA-ja vë në dispozicion Këshillit të Ankesave, regjistrimet e mbajtura sipas pikës 3 të nenit 10 më sipër.
4. Në përfundim të procedurës së shqyrtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave i dërgon ankuesit dhe OSHMA-së përkatëse konkluzionet e arsyetuara për rastin, brenda 5 ditëve nga data e arritjes së konkluzionit.

Neni 16

Pranimi i ankesës

1. Nëse e gjen të drejtë ankesën e bërë, Këshilli i Ankesave i kërkon OSHMA-së korrigimin e fakteve dhe informacioneve, në lidhje me personin e interesuar.
2. Korrigimi i fakteve dhe informacioneve bëhet në një mënyrë të ngjashme dhe kohë të njëjtë me atë të transmetimit objekt ankesë, brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga Këshilli i Ankesave.

Neni 17 **Refuzimi i ankesës nga Këshilli i Ankesave**

Këshilli i Ankesave mund të refuzojë një ankesë kur:

- a) vlerëson se ajo është abuzive dhe e pabazuar, apo e bërë në keqbesim;
- b) e drejta e kërkuar për përgjigje është opinion personal i personit dhe s'ka të bëjë me rregullimin e ndonjë lajmi me karakter fakti apo informacioni;
- c) e drejta e kërkuar për përgjigje përmban parashtrimin e fakteve dhe informacioneve të rreme;
- d) e drejta e kërkuar për përgjigje është bërë për të kërkuar parandalimin e veprimeve të pritshme apo që s'kanë ndodhur ende;
- e) përbushja e së drejtës për përgjigje përfshin një ndëshkim, kapërcen rregullat e mirësjelljes, apo sjell dënimin e ofruesit të shërbimit mediatik në një proces gjyqësor civil;
- f) përbushja e së drejtës për përgjigje sjell shkeljen e kushteve të licencës së transmetimit së OSHMA-së;
- g) personi i dëmtuar nga informacioni i kundërshtuar nuk ka interes të ligjshëm në momentin e kërkesës për ushtrimin e së drejtës së përgjigjes;
- ë) transmetimi i kundërshtuar përmban një thënie apo deklarim të personit të prekur, të tillë që konsiderohet i barasvlershëm me vetë përgjigjen e kërkuar ose kur personi ka dhënë pëlqimin paraprak në një mënyrë formale lidhur me përbajtjen e transmetimit;
- h) një korrigim i barasvlershëm i të dhënave të informacionit të kundërshtuar është bërë paraprakisht dhe për këtë është njoftuar personi i prekur;
- i) përbajtja e përgjigjes së kërkuar dhunon të drejtat e një pale të tretë;
- j) çështja objekt ankesë lidhet me thëni gjatë veprimtarive parlamentare, zhvillimit të seancave gjyqësore apo transmetimit të veprimtarive të subjekteve politike;
- k) transmetimi i së drejtës për përgjigje nuk është në interes të publikut;
- l) kërkesa është paraqitur në tejkalim të afatit.

Neni 18 **Mospërbushja e detyrimeve nga OSHMA-ja**

1. Kur Këshilli i Ankesave vëren se OSHMA-ja nuk i ka përbushur detyrimet për korrigimin e fakteve dhe informacioneve, në lidhje me personin e interesuar, njofton AMA-n.
2. AMA merr vendim në bazë të sugjerimit të Këshillit të Ankesave për rastin konkret.

Neni 19

Sanksioni për mosrespektimin e të drejtës së përgjigjes

Mosrespektimi i të drejtës së përgjigjes, sipas nenit 53 të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, të kryer nga i licencuari ose i autorizuari, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet nga AMA me sanksion me gjobë në masën 300 000 lekë.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 20 Kundërshtimi në gjykatë

Kundër vendimit të AMA-s, për sanksionimin me gjobë mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 21 Publikimi

Kjo rregullore, si dhe çdo ndryshim i saj, publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit të Mediave Audiovizive në internet, pas miratimit të saj.

Neni 22 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit nga Autoriteti i Mediave Audiovizive.